

Vendim nr. 4 datë 13.01.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 13.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (S) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **STEPHAN KARL MORGENSTERN**, përfaqësuar nga avokatët Ledi Bianku dhe Arben Braçe, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1246 (30-2023-4047), datë 22.05.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2024-2153 (294), datë 26.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që kanë pranuar kërkesën e prokurorisë për ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Polonisë.

Deklarimi se ekstradimi i kërkuesit drejt Republikës së Polonisë shkel nenet 21, 25, 27, 28, 39, pika 2 dhe 43 të Kushtetutës; nenet 3, 4, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenin 499 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 16, 17, 18, 21, 25, 27, 28, 39/2, 40, 42 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 3, 4, 5, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); Konventa Evropiane për Ekstradimin e vitit 1957 dhe protokollet shtesë I, II, III dhe IV të saj (*Konventa për Ekstradimin*); neni 499 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar (*ligji nr. 10193/2009*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për

**organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Stephan Karl Morgenstern është shtetas gjerman i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e drejtësisë polake mbi bazën e urdhrit të arrestit të datës 13.02.2024 të lëshuar nga Zyra e Prokurorisë së Rrethit Wrocllaw, Poloni, në zbatim të vendimit nr. II KP 630/23, datë 03.08.2023 të Gjykatës Rajonale Wrocllaw, Poloni, për kryerjen e veprave penale në fushën e mashtrimit dhe pastrimit të parave, sipas përcaktimeve të legjislacionit penal polak. Interpol Varshavë, Poloni në datën 05.01.2024 ka dërguar një kërkesë për bashkëpunim (*difuzion*) Interpol-it Tiranë.

2. Kërkuesi, ka qenë në kërkim ndërkombëtar me urdhrin e arrestit ndërkombëtar të dalë mbi bazën e vendimit nr. 202230930, datë 24.10.2022 të Gjykatës së Seulit, Koreja e Jugut, me të cilin ndaj tij është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, si i dyshuar për veprat penale “Mashtrim i rëndë” dhe “Shkelje e ligjit mbi rregulloren e kryerjes së biznesit për mbledhjen e fondeve”, sipas përcaktimeve të legjislacionit penal të Koresë së Jugut. Për shkak të këtij urdhri arresti ndërkombëtar, në datën 18.08.2023 kërkuesi është arrestuar përkohësisht nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në bazë të nenit 495, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1875 të regjistrimit themeltar, datë 22.08.2023, ka vleftësuar të ligjshëm arrestin e përkohshëm të kërkuesit për qëllime ekstradimi në Korenë e Jugut dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal të arrestit në burg. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Më tej, është zhvilluar procesi gjyqësor në lidhje me kërkesën e autoriteteve të drejtësisë së Koresë së Jugut për ekstradimin e kërkuesit në atë shtet. Prosesi është përmbyllur me vendimin nr. 00-2024-1408 (199), datë 25.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur përfundimisht mospranimi i kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut.

3. Ndërkohë, në lidhje me urdhrin e arrestit të autoriteteve të drejtësisë polake, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Polonisë, me kërkesën e datës 15.02.2024 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë (*Ministria e Drejtësisë*), duke kërkuar arrestimin dhe ekstradimin e kërkuesit nga Shqipëria në Poloni. Në datën 26.02.2024 Ministria e Drejtësisë i ka komunikuar Prokurorisë së Përgjithshme kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Polonisë. Në vijim, në datën 28.02.2024, kërkesa për ekstradimin së bashku me aktet shoqëruese i janë përcjellë për veprim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Mbi kërkesën e prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 286, datë 18.03.2024, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit me burg ndaj kërkuesit për efekt të ekstradimit të tij në shtetin polak.

5. Në vijim, për themelin e kërkesës për ekstradimin në shtetin polak, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 524 akti, datë 09.04.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Polonisë dhe shuarjen e masës së sigurimit personal të arrestit në burg. Sipas gjykatës, ndonëse vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi nuk është e karakterit ushtarak ose politik dhe nuk ka arsye të besohet se ai, nëse ekstradohet, do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, shtetësisë, seksit, gjendjes sociale, bindjeve politike ose të jetë objekt i trajtimeve çnjerëzore, denigruese apo poshtëruese, në shkelje të të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja, ekstradimi në rastin konkret nuk mund të lejohet, referuar nenit 489, pika 4, të KPP-së, për shkak se ndaj kërkuesit është marrë tashmë një vendim gjyqësor përfundimtar (vendimi nr. 172, datë 05.02.2024 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për rekursin ndaj të cilit Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij për ekstradimin në Republikën e Koresë së Jugut). Për rrjedhojë, nuk mund të merret edhe një vendim tjetër ekstradimi për në Republikën e Polonisë.

6. Mbi ankimin e prokurorisë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1246 (30-2023-4047), datë 22.05.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Polonisë, si dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg, të caktuar ndaj tij. Ajo gjykatë ka arsyetuar se vendimi gjyqësor që lejonte ekstradimin drejt Republikës së Koresë së Jugut (vendimi nr. 172, datë 05.02.2024 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) ende nuk është përfundimtar dhe i formës së prerë, pasi ende nuk kishte një vendim të Gjykatës së Lartë në

lidhje me ekstradimin e kërkuesit në Korenë e Jugut, ndërkohë që nuk ekziston asnjë nga ndalimet ligjore për ekstradimin e tij në shtetin polak. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në prani të palëve, sipas nenit 437, pika 1, shkronja b, të KPP-së, për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2153 (294), datë 26.11.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

8. Në datën 02.12.2024, ende pa u zbardhur vendimi i plotë i arsyetuar i Gjykatës së Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë (paraprake) për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit që lejonin ekstradimin e tij drejt Republikës së Polonisë, si të papajtueshme me Kushtetutën, deklarin e ekstradimit në shkelje të dispozitave të Kushtetutës, KEDNJ-së, Konventës për Ekstradimin dhe protokolleve shtesë të saj, legjislacionit procedural penal shqiptar, si dhe për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, deri në marrjen e një vendimi për kushtetutshmërinë e ekstradimit.

9. Në datën 06.12.2024 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se nuk rezultojn të dhëna që pasojat për të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit të ishin reale, të menjëhershme dhe të parikuperueshme. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur edhe kthimin e ankimit kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore me qëllim plotësimin e tij pas njohjes me vendimin e arsyetuar të Gjykatës të Lartë.

10. Në datën 06.01.2025 Gjykata e Lartë i ka komunikuar kërkuesit tekstin e plotë dhe të arsyetuar të vendimit të saj të datës 26.11.2024, ndërsa me shkresën nr. 6115/a prot., datë 06.01.2025, ia ka vënë në dispozicion atë edhe Gjykatës.

11. Në vijim, në datën 09.01.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankimin kushtetues individual të plotësuar, me objekt kërkimi shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë që kanë lejuar ekstradimin e tij, si dhe deklarin e ekstradimit si të pabazuar në dispozitat kushtetuese, konventore dhe ligjore.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

12.1. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor*, të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, për shkak të rrezikut real për t'u ekstraduar nga

Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut. Për këtë të fundit, Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 25.07.2024, ka refuzuar ekstradimin, me arsyetimin se të drejtat themelore të tij do të rrezikoheshin nga trajtimi çnjerëzor, gjykimi haptazi i padrejtë dhe një sërë shkeljesh të neneve 3, 4, 6 dhe 14 të KEDNJ-së. Ministri polak i Drejtësisë nuk ka dhënë garanci se kërkuesi nuk do të ekstradohet më tej në Korenë e Jugut, ndërsa garancitë e dhëna nga prokurori polak janë të pavlefshme, pasi Polonia nuk e ka ratifikuar Protokollin IV të Konventës për Ekstradimin.

12.2. Të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

- 12.2.1. *E drejta e aksesit e lidhur me zgjidhjen efektive*, sipas garancive të nenit 13 të KEDNJ-së, pasi plotësimi i kushteve për ekstradimin e tij nuk u shqyrtua në themel dhe kërkuesi nuk mori përgjigje lidhur me to nga gjykatat e faktit. *Difuzioni* i datës 05.01.2024 nuk është vlerësuar nga Komisioni për Kontrollin e Dosjeve dhe nuk plotëson kushtet e përshkruara në nenin 86 të Rregullores së Interpolit për përpunimin e të dhënave. Kërkuesi nuk është në kërkim ndërkombëtar nga Polonia. Kërkesa është dërguar vetëm me *e-mail*, i cili nuk plotëson kriteret ligjore të një kërkesë *difuzioni*. Pretendimi për paligjshmërinë e *difuzionit* nuk mori përgjigje nga gjykatat e zakonshme.
- 12.2.2. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi ndonëse në datën 19.11.2024 Gjykata e Lartë zhvilloi një seancë me praninë e prokurorit dhe përfaqësuesve ligjorë të kërkuesit, këta të fundit nuk patën mundësi të bënin replikë ndaj pretendimeve të akuzës. Duke qenë se provat e shumta të kërkuesit nuk u analizuan nga asnjë prej gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë duhet ta kishte kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit dhe të kërkonte shqyrtim në themel të saj dhe ballafaqimin e provave.
- 12.2.3. *E drejta për një gjykim të drejtë*, pasi interpretimi i nenit 425 të KPP-së nga ana e Gjykatës së Lartë është formal dhe arbitrar, sepse kjo dispozitë nuk gjen zbatim kur gjykata e apelit ka në shqyrtim ekzistencën e rrezikut për shkelje të të drejtave me karakter absolut. Edhe gjykatat e faktit, në mënyrë arbitrare, nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit për elementet e rrezikut që paraqet ekstradimi në Poloni. Gjykata e shkallës së parë ka vetëm një paragraf stereotip, ku shprehet se vepra penale nuk është e karakterit politik dhe nuk shkel dispozitat e KEDNJ-së, ndërsa gjykata e apelit refuzon *de plano* çdo analizë mbi elementet e rrezikut. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë është kufizuar vetëm në faktin se nuk ka vendim për

ekstradimin e kërkuesit në Korenë e Jugut, pa përmendur asnjë nen të KEDNJ-së dhe të Kushtetutës që mbron të drejtat substanciale të kërkuesit. Interpretimi i gabuar nga gjykatat ka shkaktuar shkeljen e neneve 17, pika 2 dhe 122, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenet 25 dhe 39, pika 2, të saj. Po kështu, edhe interpretimi arbitrar i nenit 5 të Konventës për Ekstradimin ka cenuar nenet 5 dhe 122 të Kushtetutës.

- 12.2.4. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor në përmbajtje. I njëjti kolegji, ndaj të njëjtit person, në vendimin për mospranimin e ekstradimit në Korenë e Jugut referon natyrën e analizës që duhet të kryejnë gjykatat në raste dëbimesh ose ekstradimesh sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), por e harron këtë në vendimin objekt kundërshtimi. Gjykata e Lartë është e pasaktë kur arsyeton lidhur me garancitë e ekstradimit, ndonëse në të dyja rastet përdoret i njëjti term. Kështu, termi “dhe të tjerë” i përdorur në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Polonisë është identik me termin “”etj.” të përdorur nga ai i Republikës së Koresë së Jugut, që do të thotë se në rastin konkret shteti polak nuk ka ofruar garancitë e kërkuara.
- 12.2.5. *E drejta për t’u mbrojtur*, pasi përfaqësuesit ligjorë nuk kanë pasur njoftim në procesin e zhvilluar nga autoritetet polake për seancën paraprake ku u caktua masa e arrestit, e cila u zhvillua në mungesë të mbrojtësve, duke e lënë kërkuesin të pambrojtur dhe të papërfaqësuar. Ai nuk ka pasur qasje në çdo provë të mundshme shfajësuese, ndërsa një pjesë e akteve të dosjes janë të shkruara në gjuhën greke dhe të papërkthyer në gjuhën polake, kurse mundësia për të bërë kopje i është mohuar. Ai nuk është thirrur asnjëherë nga autoritetet polake dhe nuk është vënë në dijeni të ndonjë procedure penale në ngarkim të tij dhe as për ndonjë dyshim të lidhur me ndonjë veprim ose mosveprim të tij. Vendimet e marra nga pala polake ndaj tij janë *in absentia*, gjë që përbën shkelje flagrante të drejtësisë. Përfundimet e sugjeruara nga pala polake në kërkesën për ekstradim se ai po përpiqet t’i shmanget përgjegjësisë penale dhe autoriteteve polake, janë të pabaza. Lidhur me këto shkelje nga autoritetet polake, kërkuesi ka paraqitur 3 kërkesa në GJEDNJ, përkatësisht në datat 16.10.2023, 06.11.2023 dhe 22.01.2024, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk bën analizën e problemeve sistematike dhe as ato individuale në procedurat ndaj tij.

- 12.2.6. *E drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme* të lidhur me procesin gjyqësor polak. Në Poloni akuzat ndaj kërkuesit janë bazuar në informacione kontradiktore dhe të pasakta, ndërkohë që shoqëria tregtare me të cilën ka kryer veprime nuk është polake dhe ai nuk është shtetas polak, ndaj nuk mund të jetë përgjegjës për pagesën e TVSH-së në Poloni. Autoritetet polake nuk kanë ofruar asnjë provë dhe as nuk kanë tentuar të shpjegojnë se si kërkuesi ka kryer mashtrime me pagesën e TVSH-së, nuk kanë identifikuar asnjë viktimë dhe as shumat ose rrethanat e mashtrimit. Pretendimet e palës polake për rolin e tij në shoqërinë tregtare të regjistruar në Ishujt Marshall janë të pabazuara, pasi ai nuk ka asnjë lidhje me këtë shoqëri tregtare. Autoritetet polake nuk kanë sjellë të dhëna të rëndësishme fajësie dhe prokuroria shqiptare nuk ka kërkuar prej tyre asnjë provë që ta bëjnë të ligjshëm ekstradimin. Ndërsa kërkuesi i ka evidentuar këto pretendime në gjykatën e shkallës së parë, prokuroria ka dështuar të sjellë prova për të mbështetur themelin e ankimit të saj.
- 12.3. *Ekstradimi është në kundërshtim me aktet ndërkombëtare*, pasi kërkuesi është akuzuar nga autoritetet polake për shkeljen e ligjit për TVSH-në sipas Kodit Penal Tatimor, ndërkohë që vepra penale me karakter fiskal nuk i nënshtrohet ekstradimit sipas Konventës për Ekstradimin. Gjithashtu, urdhri evropian ndaj tij nuk është i zbatueshëm për Republikën e Shqipërisë, por vetëm në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në një situatë të ngjashme, në çështjen *Groni kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja gjeti shkelje nga autoritetet shqiptare.
- 12.4. *Parimin e specialitetit*, pasi autoritetet polake nuk kanë treguar se kush kanë qenë viktimat e akteve të kërkuesit, si dhe as të dhëna konkrete për veprat penale të mashtrimit dhe pastrimit të parave. Informacionet e këtyre autoriteteve janë të përgjithshme dhe të vagëta dhe nuk përmbushin kërkesat e nenit 12 të Konventës për Ekstradimin. Ndonëse hetimi ka filluar që në datën 05.08.2023, nuk ka asnjë informacion nga autoritetet polake për ecurinë dhe përpjekjet e tyre për t'i bërë ato efektive. Autoritetet polake nuk kanë specifikuar qartë veprën penale për të cilën kërkohet kërkuesi dhe as rrethanat e kryerjes së saj, duke vepruar në kundërshtim me Konventën për Ekstradimin. Po kështu, autoritetet polake pranojnë hapur në *difuzionin* e datës 05.01.2024 se kërkuesi po ndiqet penalisht edhe për vepra penale të kryera në vende të tjera, pa specifikuar se cilat janë këto vende dhe nëse përfshihet edhe Koreja e Jugut. Kjo deklaratë shkel hapur këtë parim dhe vendimin e datës 25.07.2024 të Gjykatës së Lartë.

12.5. *Procedura e ekstradimit është e paligjshme*, në kushtet kur një kërkesë për azil politik është në proces shqyrtimi nga autoritetet shqiptare. Nëpërmjet plotësimit të kërkesës së paraqitur në datën 13.12.2024, kërkuesi ka kërkuar azil në Republikën e Shqipërisë ndaj Republikës së Polonisë. Rrjedhimisht, vendimi i ekstradimit, në kushtet kur kërkesa për azil është ende në proces shqyrtimi, do të përbënte shkelje flagrante të legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar, si Konventa për Refugjatët, dispozitat e Komisionit të Lartë të OKB-së për Refugjatët dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ai justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i

ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës së aksesit, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe për zgjidhje efektive, sipas nenit 13 të KEDNJ-së, mbështetur në dy argumente kryesore: (i) për shkak të paligjshmërisë së *difuzionit* të datës 05.01.2024; (ii) për shkak se plotësimi i kushteve për ekstradimin nuk u shqyrtua në themel dhe ai nuk mori përgjigje për to nga gjykatat e faktit. Lidhur me argumentin e parë, kërkuesi ka parashtruar se *difuzioni* nuk ishte aktiv, ndaj për të nuk kishte një urdhër ndërkombëtar kërkimi. Sipas kërkuesit, pretendimi i tij për paligjshmërinë e *difuzionit* nuk mori përgjigje nga gjykatat. Gjithashtu, sipas kërkuesit, vendimi kuadër për Urdhrin Evropian të Arrestit nuk është i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, por vetëm në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

17. Për sa i përket këtij argumenti, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ligjshmëria e *difuzionit*, në thelb, ka të bëjë me procedurën e arrestimit të përkohshëm të kërkuesit për qëllime të ekstradimit, për të cilën kërkuesi nuk ka paraqitur ankim kushtetues individual. Ndërkohë që objekt i ankimit kushtetues individual në shqyrtim është (pa)rregullsia e procedurave gjyqësore në marrjen e vendimit për lejimin e ekstradimit të kërkuesit, e cila bazohet në kërkesën e autoriteteve të drejtësisë polake, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave konventore që rregullojnë procedurat e ekstradimit. Ky qëndrim është shprehur edhe nga gjykatat e zakonshme, ku Gjykata e Lartë ka pohuar se ekstradimi i kërkuesit është bazuar në kërkesën me shkrim të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Polonisë komunikuar ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë (*shih paragrafët 35 dhe 36 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe zgjidhjes efektive, mbështetur në argumentin për paligjshmërinë e *difuzionit*, nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa sa i takon argumentit të dytë për cenimin e së drejtës së aksesit dhe zgjidhjes efektive, ashtu si edhe për pretendimet e tjera të parashtruara përpara Gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera kërkimi në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

18. Po kështu, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 26.11.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 02.12.2024 dhe është plotësuar në datën 09.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore për lejimin e ekstradimit të tij nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Polonisë

kanë cenuar të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor, të drejtën për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (aksesi i lidhur me zgjidhjen efektive, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, gjykimi i drejtë, standardi i arsytimit, mbrojtja, si dhe gjykimi i pavarur dhe i paanshëm) dhe parimet ndërkombëtare të ekstradimit (parimin e specialitetit, lejimin e ekstradimit në kundërshtim me aktet ndërkombëtare dhe ligjore përfshirë edhe ato që rregullojnë procedurën e azilit, si dhe të drejtën për të mos u ekstraduar për vepra penale të cilat nuk janë të ekstradueshme). Këto pretendime lidhen me shkeljen e neneve 5, 39, 42, 43 dhe 122 të Kushtetutës, neneve 3, 4, 5, 6 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe neneve 5, 6 dhe 14 të Konventës për Ekstradimin, ndaj *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe do të analizohen në vijim.

20. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi e ka lidhur pretendimin për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor me argumentin e rrezikut për ekstradimin e mëtejshëm të tij nga Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut dhe mungesën e garancive për moslejimin e ekstradimit të tij në atë shtet. Sipas tij, kushtet çnjerëzore dhe degraduese në Korenë e Jugut janë njohur qartë nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 00-2024-1408 (199), datë 25.07.2024, me të cilin është refuzuar ekstradimi i tij në atë vend. Gjithashtu, sipas kërkuesit, autoritetet polake nuk kanë dhënë garancitë e duhura dhe të besueshme se ai nuk do të ekstradohet nga Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut. Mbi të njëjta argumente për mungesën e garancive të autoriteteve polake, kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të specialitetit*. Lidhur me këtë parim, kërkuesi ka parashtruar se autoritetet polake nuk kanë qenë asnjëherë në gjendje të tregonin se kush kanë qenë viktimat e veprave penale dhe as rrethanat e atyre veprave, duke vepruar në kundërshtim me Konventën për Ekstradimin.

21. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se Gjykata e Lartë duke iu referuar përmbajtjes literale të kërkesës për ekstradim, datë 15.02.2024 të ministrit të Drejtësisë së Polonisë, të cilën e ka cituar në vendim, ka nxjerrë përfundimin se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, janë dhënë garanci të shprehura që, pa lejen e autoriteteve shqiptare, ai të mos vihet përpara përgjegjësisë penale për vepra penale që nuk përfshihen në kërkesën për ekstradim dhe as të mos u dorëzohet autoriteteve të një shteti tjetër (*shih paragrafët 41 – 45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, nuk ka shkelje të parimit të specialitetit, pasi nuk ekziston dyshimi se kërkuesi mund të ndiqet edhe për vepra të tjera të cilat nuk janë listuar në kërkesën për ekstradim. Sipas saj, kërkesa e autoriteteve polake përmban dispozitat penale për të cilat akuzohet kërkuesi, faktet në mënyrë të përmbledhur, si dhe garancinë e shtetit polak. Po kështu, shprehet Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, plotësohet kushti ligjor i kërkuar nga neni 498, pika 1 i KPP-së dhe ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e shtetit të kërkuar nuk ka kompetencë dhe nuk mund

të vlerësojë vendimin e marrë nga autoriteti i huaj gjyqësor për sa i përket nivelit dhe cilësisë së provave për të cilat është ngritur dyshimi i arsyeshëm dhe është disponuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg” (*shih paragrafët 56, 59 dhe 69 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Gjykata e Lartë i është përgjigjur pretendimit të kërkuarit mbi ekzistencën e garancive, si dhe mbi faktin se ai kërkohet nga autoritetet e drejtësisë polake për akuza konkrete, të cilat përmbajnë elemente specifike të fakteve penale në ngarkim të tij. Duke analizuar vendimin e Gjykatës së Lartë konstatohet se nuk ka ndonjë arsye serioze për të vënë në dyshim interpretimin e ligjit që ajo u ka bërë fakteve të çështjes së kërkuarit. Për më tepër, Gjykata e Lartë, në një proces të mëparshëm ekstradimi, me vendimin nr. 00-2024-1408 (199), datë 25.07.2024, ka vendosur në mënyrë përfundimtare mospranimin e kërkesës së autoriteteve koreane jugore për ekstradimin e kërkuarit në Republikën e Koresë së Jugut. Kjo do të thotë se nga autoritetet gjyqësore shqiptare tashmë ka një vendim gjyqësor përfundimtar që nuk e lejon ekstradimin e kërkuarit në shtetin në të cilin ai ka pretenduar rrezikun e cenimit të të drejtave themelore të tij. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe parimit të specialitetit* janë haptazi të pabazuara.

23. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me zgjidhjen efektive* (*shih supra paragrafin 16 të vendimit*), kërkuari ka parashtruar edhe argumentin e dytë, sipas të cilit plotësimi i kushteve për ekstradimin e tij nuk u shqyrtua në themel dhe ai nuk mori përgjigje për to nga gjykatat e faktit. Sipas tij, asnjë nga gjykatat nuk ka shqyrtuar në themel pretendimet e tij, nuk ka trajtuar asnjë nga argumentet dhe nuk i ka dhënë përgjigje pyetjes themelore nëse përmbusheshin kushtet e ekstradimit të kërkuarit.

24. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, se në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, gjykatat i kanë dhënë përgjigje atij se në rastin në fjalë plotësohen kushtet ligjore për lejimin e ekstradimit. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenet 490 dhe 491 të KPP-së rezulton se veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi nuk janë të karakterit ushtarak ose politik, ndaj nuk ka arsye të besohet se kërkuari, nëse ekstradohet, do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, shtetësisë, seksit, gjendjes sociale, bindjeve politike, apo se do të jetë objekt i trajtimeve çnjerëzore, denigruese ose poshtëruese, në shkelje të të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja. Gjykata e shkallës së parë më tej ka vlerësuar se ndaj kërkuarit është disponuar me vendim gjyqësor për ekstradimin e tij në Korenë e Jugut, që përbënte një kusht tjetër ligjor për të mos lejuar ekstradimin (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*).

25. Kurse gjykata e apelit, e vënë në lëvizje vetëm mbi bazën e ankimit të prokurorit, ka vlerësuar se ndalimi ligjor që ishte evidentuar nga gjykata e shkallës së parë nuk ekzistonte, sepse procedura gjyqësore për ekstradimin e kërkuesit në Korenë e Jugut nuk ishte bërë ende përfundimtare. Në këtë mënyrë, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke lejuar ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Polonisë, që do të thotë se ka shprehur të njëjtin vlerësim me atë të shkallës së parë se në rastin e kërkuesit përmbushen kushtet e tjera ligjore të ekstradimit (*shih paragrafët 36 - 38 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*). Vlerësimi i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, e cila ka pranuar, gjithashtu, se plotësohen kushtet ligjore të ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Polonisë (*shih paragrafët 30 – 33 të Gjykatës së Lartë*).

26. Në analizë të qëndrimeve të shprehura nga gjykatat e zakonshme, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ato u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke u shprehur për plotësimin e kushteve të ekstradimit të tij në Republikën e Polonisë. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesit për *cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me zgjidhjen efektive*, i mbështetur në argumentin se plotësimi i kushteve për ekstradimin e tij nuk u shqyrtua në themel dhe ai nuk mori përgjigje lidhur me to nga gjykatat e zakonshme, është haptazi i pabazuar.

27. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, duke parashtruar se në datën 19.11.2024 Gjykata e Lartë ka realizuar një seancë me praninë e prokurorit dhe përfaqësuesve ligjorë, por këta të fundit nuk patën mundësi të bënin replikë ndaj pretendimeve të prokurorit. Sipas kërkuesit, provat e shumta të tij nuk u analizuan nga asnjë prej gjykatave të faktit, rrjedhimisht Gjykata e Lartë duhet ta kishte kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit dhe të urdhëronte ballafaqimin e provave dhe shqyrtimin e çështjes në themel.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj për nenin 39, pika 2, të Kushtetutës, ka pohuar se togfjalëshi “*vetëm me vendim gjyqësor*” do të thotë se lejimi i ekstradimit vlerësohet përmes një procesi gjyqësor, i cili në këto raste duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe të materializuara në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimet nr. 48, datë 11.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, Gjykata ka theksuar se ai është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t’u mbrojtur në një gjykim të drejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*), standard i cili në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve gjen zbatim edhe në procedurat gjyqësore të ekstradimit.

29. Mbi bazën e këtij standardi, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit në seancë gjyqësore, në prani të palëve, sipas nenit 437, pika 1, shkronja “b” të KPP-së, pasi, sipas saj, u vlerësua e nevojshme thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes, sepse janë ngritur çështje të zbatimit të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit dhe se vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në seancën gjyqësore të zhvilluar për këtë çështje palët paraqitën pretendimet dhe prapësimet e tyre, të cilave Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencën e saj për çështje të zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, u ka dhënë përgjigje në vendimin e saj, duke përfshirë edhe pretendimet e kërkuarit lidhur me plotësimin e kushteve të ekstradimit dhe vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* është haptazi i pabazuar.

30. Pretendimi tjetër i kërkuarit lidhet me *gjykimin e drejtë*, pasi, sipas tij, Gjykata e Lartë ka gabuar në interpretimin e nenit 425 të KPP-së, sepse kjo dispozitë nuk gjen zbatim kur gjykata e apelit ka në shqyrtim ekzistencën e rrezikut për shkelje të të drejtave themelore me karakter absolut. Sipas kërkuarit, gjykatat e faktit nuk kanë analizuar rrezikun në shkeljen e të drejtave themelore në rast ekstradimi të mundshëm të tij drejt Koresë së Jugut.

31. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se ekstradimi parashikohet drejtpërdrejt nga Kushtetuta, neni 39, pika 2, i së cilës përcakton se ai mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Referuar Konventës për Ekstradimin, ekstradimi konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në veçanti ekstradimi për jashtë shtetit, janë rregulluar më hollësisht nga KPP-ja dhe ligji nr. 10193/2009.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vënë në dukje se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ndaj kërkuarit është kërkuar zbatimi i procedurave të ekstradimit drejt dy shteteve, Koresë së Jugut dhe Polonisë. Për sa i takon kërkesës për lejimin e ekstradimit në Republikën e Koresë së Jugut, gjykatat e faktit kanë vendosur

në favor të saj, ndërsa Gjykata e Lartë është shprehur kundër ekstradimit, duke vendosur përfundimisht mospranimin e kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit. Ndërsa procedurat gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim drejt Republikës së Koresë së Jugut ende nuk kishin përfunduar plotësisht, pasi pritej vendimi i Gjykatës së Lartë, kanë nisur procedurat për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Polonisë. Lidhur me këtë të fundit, gjykata e shkallës së parë ka verifikuar se ndërsa plotësoheshin kushtet e tjera ligjore të ekstradimit, duke i analizuar shprehimisht ato, për kërkuesin ishte miratuar më herët kërkesa për ekstradimin e tij në Republikën e Koresë së Jugut, ndaj, për këtë arsye, ajo ka disponuar mospranimin e kërkesës për lejimin e ekstradimit në Republikën e Polonisë.

34. Prokuroria ka paraqitur apel, duke ngritur shkakun se ndaj kërkuesit, në ndryshim nga sa kishte vlerësuar gjykata e shkallës së parë, nuk kishte pengesë për ekstradimin në Republikën e Polonisë, pasi nuk kishte ende një vendim gjyqësor përfundimtar për ekstradimin e tij në Republikën e Koresë së Jugut. Gjykata e apelit, bazuar në nenin 425 të KPP-së, që përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë, ka ndryshuar vendimin, duke analizuar vetëm shkakun e ngritur në apel. Sipas gjykatës së apelit, duke qenë se nuk ka ende një vendim nga Gjykata e Lartë për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut, kjo ndalesë nuk ekziston, ndaj gjykata e shkallës së parë duhet të kishte marrë vendim për lejimin e ekstradimit në Republikën e Polonisë, për sa kohë kushtet e tjera ligjore plotësoheshin. Me këtë arsyetim, ajo gjykatë ka disponuar lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Polonisë (*shih paragrafin 37 të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*).

35. Në vijim, Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesit, e ka vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duke evidentuar se ajo kishte shqyrtuar çështjen brenda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se në ankim, prokuroria nuk kishte parashtruar shkaqe ankimi për ekzistencën ose jo të kushteve të tjera të ekstradimit, pasi gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkesa plotëson kushtet e parashikuara nga nenet 490 dhe 491 të KPP-së, por e ka lidhur atë me mungesën e provave që ndaj kërkuesit ishte miratuar kërkesa për ekstradimin e tij në Korenë e Jugut (*shih paragrafin 32 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar shkakun e rekursit të kërkuesit lidhur me interpretimin e nenit 425 të KPP-së, duke theksuar se kjo dispozitë ligjore nuk bën diferencim lidhur me llojet e çështjeve që vijnë në shqyrtim në gjykatën e apelit. Sipas saj, ka disa përjashtime që lejojnë gjykatën të shtrijë gjykimin në apel edhe përtej shkaqeve të ankimit, ku kjo lidhet me konstatimin edhe kryesisht nga gjykata të pavlefshmërisë absolute të akteve ose/dhe papërdorshmërinë e provave, edhe nëse kjo nuk është

kërkuar nga palët në ankim. Parashikimi “për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht” interpretohet për çështje të pavlefshmërisë absolute të akteve ose/dhe papërdorshmërinë e provave, por jo për çdo pretendim që mund të paraqesë pala gjatë gjykimit të çështjes në apel, sikurse pretendon rekursuesi (*shih paragrafin 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

36. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, interpretimi i nenit 425 të KPP-së është jo vetëm brenda kompetencës kushtetuese të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit, por nuk rezulton as të jetë arbitrar, në kuptimin e gabimeve ligjore. Për më tepër, ashtu siç u theksua, në rastin e kërkuesit janë dhënë garanci të shprehura nga autoritetet polake, se pa pëlqimin e autoriteteve shqiptare ai nuk do të ekstradohet nga Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut (*shih supra paragrafët 21 - 22 të vendimit*), ndaj argumenti se gjykata e apelit duhet t’i shrinte kufijtë e shqyrtimit të çështjes përtej shkaqeve të apelit, duke shqyrtuar sërish nga e para plotësimin e kushteve ligjore të ekstradimit për shkak të rrezikut të shkeljeve të të drejtave themelore me karakter absolut, nuk qëndron. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës për një gjykim të drejtë*, bazuar në argumentin se interpretimi i nenit 425 të KPP-së nga Gjykata e Lartë ishte arbitrar, është haptazi i pabazuar.

37. Lidhur me pretendimin për cenimin e *standardit të arsytimit*, kërkuesi ka parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor në përmbajtje. Sipas tij, i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë ndaj të njëjtit person, kërkuesit, në vendimin për mospranimin e ekstradimit në Korenë e Jugut ka zbatuar standardet e jurisprudencës së GJEDNJ-së, të cilat i ka harruar në vendimin e kundërshtuar. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë është e pasaktë kur arsyeton lidhur me garancitë e ekstradimit në dy procedurat ndaj kërkuesit, pasi në të dyja rastet autoritetet kanë përdorur të njëjtin term “dhe të tjerë” dhe “etj.” për veprat penale, që do të thotë se autoritetet polake, njësoj si autoritetet koreane jugore, nuk kanë ofruar garancitë e duhura.

38. Në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë, dhe argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë ka evidentuar në pjesën arsyetuese të vendimit të saj se për të njëjtin kërkues ajo ishte shprehur më herët me vendimin e datës 25.07.2024, i cili ka pasur për objekt shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë për ekstradimin e tij drejt Republikës së Koresë së Jugut, për arsytet e referuara në atë vendimmarrje, të tilla, si, shkelje e parimit të specialitetit në veprat penale për të cilat është akuzuar, puna e detyruar dhe shkelje të neneve 3 dhe 4 të KEDNJ-së. Ndryshe nga rasti i ekstradimit drejt Republikës së Koresë së Jugut, sipas Gjykatës së Lartë, kërkesa për ekstradimin e kërkuesit nga autoritetet polake nuk lë të hapur mundësinë që pas ekstradimit ai të akuzohet edhe për vepra të tjera penale përveç atyre që citohen në vendimmarrjen e autoriteteve gjyqësore polake (*shih paragrafët 61 - 63 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Ndërsa për sa i takon përdorimit të termit “*dhe të tjerë*” në kërkesën për ekstradim të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Polonisë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ky term i përdorur në atë shkresë nuk tregon se kërkuesi do të ndiqet për vepra të tjera, pasi ministri i Drejtësisë nëpërmjet kësaj kërkesë ka dërguar për veprim kërkesën e prokurorisë, datë 13.02.2024, e cila është bazuar në akuzat konkrete të referuara në vendimin e gjykatës, datë 23.01.2024 (*shih paragrafin 69 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

40. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban kontradiksione në pjesën arsyetuese të tij, por pretendimit të kërkuesit i janë dhënë mjaftueshëm arsye edhe se përse rasti konkret, ai i shqyrtimit të kërkesës për ekstradimin drejt Republikës së Polonisë, nuk gjendej në të njëjta kushte me atë të shqyrtimit të kërkesës për ekstradimin drejt Republikës së Koresë së Jugut. Po kështu, ajo gjykatë ka analizuar në mënyrë të arsyeshme përdorimin e termit “*dhe të tjerë*” në kërkesën e ministrit të Drejtësisë të Republikës së Polonisë. Për rrjedhojë, vlerësimi i Gjykatës së Lartë për përfundimin e arritur nuk rezulton i paarsyeshëm, pasi ai nuk përmban kundërthënie dhe as të meta të tilla serioze që të vërë në dyshim standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është haptazi i pabazuar.

41. Dy pretendimet e tjera të kërkuesit lidhen me cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur* dhe *së drejtës për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme nga autoritetet e drejtësisë polake*, me argumentet se në procesin penal në Poloni, përfaqësuesit ligjorë nuk kanë pasur njoftim nga autoritetet polake për seancën paraprake ku është caktuar masa e arrestit, e cila është zhvilluar në mungesë të mbrojtësve, duke e lënë atë të pambrojtur dhe të papërfaqësuar. Kërkuesi ka parashtruar se lidhur me shkeljet nga autoritetet polake, ai ka paraqitur tre kërkesa në GJEDNJ, përkatësisht në datat 16.10.2023, 06.11.2023 dhe 22.01.2024, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk ka bërë analizën e problemeve sistematike dhe as ato individuale në procedurat ndaj tij. Po kështu,

sipas kërkuesit, në Poloni akuzat ndaj tij janë bazuar në informacione kontradiktore dhe të pasakta, ndërkohë që shoqëria tregtare me të cilën ka kryer veprime nuk është polake dhe ai nuk është shtetas polak, ndaj nuk mund të jetë përgjegjës për pagesën e TVSH-së në atë shtet. Autoritetet polake nuk kanë ofruar asnjë provë dhe as nuk kanë tentuar të shpjegojnë se si kërkuesi ka kryer mashtrime me pagesën e TVSH-së, nuk kanë identifikuar asnjë viktimë dhe as shumat ose rrethanat e mashtrimit. Autoritetet polake nuk kanë sjellë të dhëna të rëndësishme fajësie dhe prokuroria shqiptare nuk ka kërkuar prej tyre asnjë provë që ta bëjë të ligjshëm ekstradimin. Ndërsa kërkuesi i ka evidentuar këto pretendime në gjykatën e shkallës së parë, prokuroria ka dështuar të sjellë prova për të mbështetur themelin e ankimit të saj.

42. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e autoriteteve polake kërkuesi e ka parashtruar edhe në rekurs, për të cilin Gjykata e Lartë është shprehur se Polonia, si anëtare e Këshillit të Evropës, ka miratuar KEDNJ-në dhe për më tepër, shteti polak ka dhënë garanci se kërkuesit do t'i garantohen të drejtat e tij në procesin penal në bazë të dispozitave procedurale penale. Gjithashtu, Gjykata e Lartë është shprehur se kërkuesi kërkohet për veprat penale të mashtrimit, grupit të strukturuar kriminal, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe fshehjes së të ardhurave. Sipas saj, nuk konstatohet rrezik real i shkeljes ose mohimit flagrant të së drejtës për një proces të rregullt të tij nga ana e shtetit polak. Ndërsa lidhur me shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ-ja ndaj Polonisë në çështjen e sjellë në vëmendje nga kërkuesi, ajo gjykatë ka arsyetuar se në rastin e ekstradimit, nisur nga situata personale, nuk konstatohet rrezik real që ndaj kërkuesit nuk do të garantohet e drejta për një proces të rregullt, për më tepër shteti polak ka kërkuar ekstradimin me qëllim pjesëmarrjen gjatë procedimit të tij penal (*shih paragrafët 52 – 56 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

43. Nga ana tjetër, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ky pretendim i kërkuesit është vlerësuar prej saj edhe në vendimin e ndërmjetëm të datës 06.12.2024, nëpërmjet të cilit ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për pezullimin e procedurave të ekstradimit. Në atë vendim, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vënë në dukje se Republika e Polonisë është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe i Konventës për Ekstradimin, çka prezumon funksionimin e një sistemi drejtësie të zhvilluar sipas standardeve të duhura, që ofron garanci të mjaftueshme në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtave themelore të tij, bazuar në argumentin e mungesës së pavarësisë së sistemit gjyqësor polak, është hipotetik dhe nuk përlligj kërkesën për pezullimin e procedurave të ekstradimit (*shih paragrafin 15 të vendimit të datës 06.12.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, përfshirë procedurat e ekstradimit, vepron

parimi i besimit të ndërsjellë ndërmjet shteteve, ndaj, në këtë këndvështrim, prezumohet ligjshmëria e veprimeve të autoriteteve polake dhe i bie barra kërkuesit të provojë të kundërtën.

44. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi jo vetëm që ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimet, por, nga ana tjetër, argumentet e tij, të cilat lidhen kryesisht me vlerësimin e provave, nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin për mungesën e *pavarësisë së autoriteteve të drejtësisë polake*.

45. Kërkuesi ka ngritur edhe pretendimin se procedura e ekstradimit të tij është e paligjshme për shkak të paraqitjes së *kërkesës për azil në Republikën e Shqipërisë*. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi fillimisht në datën 26.12.2023, bazuar në ligjin për azilin, ka paraqitur kërkesë për azil bazuar në rrethanën e ekstradimit të tij në Republikën e Koresë së Jugut, ekstradim i cili u refuzua nga Gjykata e Lartë. Ndërkohë, në datën 13.12.2024, rreth 17 ditë pas dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë (datë 26.11.2024) për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Polonisë ai ka paraqitur plotësim kërkesë për azil. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se shtesa e kërkesës për azil, e paraqitur pasi procedura gjyqësore për lejimin e ekstradimit në Republikën e Polonisë u bë përfundimtare, nuk përbën rrethanë që të vendosë në dyshim vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme për lejimin e ekstradimit.

46. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për moslejimin e ekstradimit për vepra penale të paekstradueshme*, kërkuesi ka argumentuar se ai është akuzuar nga autoritetet polake për shkeljen e ligjit për TVSH-në sipas Kodit Penal Tatimor, ndërkohë që vepra penale me karakter fiskal nuk i nënshtrohen ekstradimit. Lidhur me këtë, sipas kërkuesit, interpretimi i Gjykatës së Lartë, referuar relacionit shpjegues të Konventës për Ekstradimin nuk qëndron, pasi nuk ka asnjë akt të përbashkët mes shteteve për këtë qëllim.

47. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, në thelb, ky pretendim është i lidhur me të drejtën kushtetuese të shtetasit të huaj për të mos u dëbuar nga territori i Republikës së Shqipërisë, e cila gjendet e garantuar në nenin 39, pika 3, të Kushtetutës, sipas së cilës dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj. Këto (kushtet) janë detajuar në KPP dhe në ligjin nr. 10193/2009, të cilat, siç kanë vlerësuar gjykatat e zakonshme, janë plotësuar në rastin e kërkuesit (*shih supra paragrafët 24 – 25 të vendimit*). Nga ana tjetër, neni 5 i Konventës për Ekstradimin ka përcaktuar rregulla lidhur me ekstradimin për sa u takon shkeljeve financiare. Koncretisht, sipas kësaj dispozite, në fushën e taksave dhe tatimeve, doganës, këmbimit të monedhave, ekstradimi do të akordohet në kushtet e parashikuara nga kjo konventë, vetëm nëse është vendosur kështu midis palëve kontraktuese për çdo shkelje ose kategori shkeljesh.

48. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ky pretendim është parashtruar nga kërkuesi edhe në shkaqet e rekursit, të cilin Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar, pasi, sipas saj, kërkuesi akuzohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit Penal Tatimor polak. Veprat penale të parashikuara nga legjislacioni penal polak, për të cilat akuzohet kërkuesi gjenden të parashikuara edhe në Kodin Penal shqiptar, sikurse neni 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, neni 143/3 “Mashtrimi”, neni 287 “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 180 “Fshehja e të ardhurave” (*shih paragrafin 65 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

49. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesa për ekstradim dëshmon se ndaj kërkuesit është regjistruar një procedim penal në shtetin polak, që do të thotë se ai dyshohet të ketë kryer vepra penale të dënueshme nga legjislacioni penal material polak, të cilat janë njëherazi të dënueshme edhe nga legjislacioni penal shqiptar. Në këtë mënyrë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se, ndonëse disa sjellje të dyshuara si të paligjshme të kërkuesit lidhen me fushën fiskale, ekstradimi i tij kërkohet edhe për sjellje të parashikuara si vepra penale të dënueshme nga kodet respektive penale të të dyja vendeve, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të Konventës për Ekstradimin. Për pasojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

50. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara, ndaj çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

51. Në kërkesën plotësuese të ankimit kushtetues individual, të paraqitur në datën 09.01.2025, kërkuesi ka parashtruar, gjithashtu, se ekstradimi i tij në Republikën e Polonisë është planifikuar të realizohet në datën 14.01.2025, ndaj mospezullimi i kësaj procedure deri sa Gjykata të shprehet për themelin e kërkesës do ta bënte vendimin e saj të pakuptimtë dhe pa efekt në praktikë. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në kushtet kur çështja nuk plotëson kriteret paraprake për t’u shqyrtuar në seancë plenare, bazuar në nenin 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk ka vend për të vendosur pezullimin e procedurave të ekstradimit të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Stephan Karl Morgenstern, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1246 (30-2023-4047), datë 22.05.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nr. 00-2024-2153 (294), datë 26.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe deklarimin e ekstradimit të tij drejt Republikës së Polonisë në shkelje të Kushtetutës, KEDNJ-së, KPP-së dhe ligjit nr. 10193/2009, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur, pasi vlerësojmë se kërkesa plotësonte edhe kriterin paraprak të legjitimitimit *ratione materiae*, ndaj duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare për arsyt e mëposhtme.

2. Në mënyrë të përmbledhur nga rrethanat e çështjes ka rezultuar se kërkuesi është shtetas gjerman dhe është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e drejtësisë polake, pasi dyshohet se ka kryer vepra penale në fushën e mashtrimit dhe pastrimit të parave, sipas përcaktimeve të legjislacionit penal polak. Ndërkohë që më herët kërkuesi ka qenë në kërkim ndërkombëtar edhe nga autoritetet gjyqësore të Republikës së Koresë së Jugut, si i dyshuar për vepra penale sipas përcaktimeve të legjislacionit penal të Koresë së Jugut. Për këtë qëllim është kërkuar ekstradimi i tij drejt Republikës së Koresë së Jugut. Kjo kërkesë i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat e zakonshme shqiptare dhe në përfundim të gjykimit Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1408 (199), datë 25.07.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut.

3. Përgjatë kohës që po shqyrtohej kërkesa për lejimin e ekstradimit në Republikën e Koresë së Jugut, kanë nisur procedurat për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Polonisë. Pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2153 (294), datë 26.11.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1246 (30-2023-4047), datë 22.05.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë që pranonte kërkesën e prokurorisë për lejimin ekstradimit të kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Polonisë.

4. Pas përfundimit të procesit gjyqësor, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit dhe me kërkesë për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë deri në marrjen e një vendimi për kushtetutshmërinë e ekstradimit. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendim të ndërmjetëm, në datën 06.12.2024 ka vendosur (me shumicë votash) rrëzimin e kërkesës për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndërsa për sa i takon kushtetutshmërisë së vendimeve që kanë pranuar kërkesën e prokurorit për lejimin e ekstradimit në Republikën e Polonisë, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për të mos iu nënshtruar

trajtimin çnjerëzor, të drejtën për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (aksesi i lidhur me zgjidhjen efektive, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, gjykimi i drejtë, standardi i arsyetimit, mbrojtja, si dhe gjykimi i pavarur dhe i paanshëm) dhe parimet ndërkombëtare të ekstradimit (parimin e specialitetit, lejimin e ekstradimit në kundërshtim me aktet ndërkombëtare dhe ligjore përfshirë edhe ato që rregullojnë procedurën e azilit, si dhe të drejtën për të mos u ekstraduar për vepra penale të cilat nuk janë të ekstradueshme).

5. Ne gjyqtarët në pakicë, duke ndarë fillimisht mendimin se çdo pretendim i kërkuesit duhet t'i nënshtrohej shqyrtimit të detajuar në themel në seancë plenare nga Gjykata, me qëllim garantimin e një vlerësimi të plotë dhe të drejtë të procesit në tërësi të ndjekur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Polonisë, çmojmë të analizojmë disa nga pretendimet dhe argumentet kryesore të kërkuesit që përbëjnë thelbin e procedurës së ekstradimit, bazueshmëria e të cilave përbën mjaftueshëm arsye që kërkesa e tij të mos konsiderohej haptazi e pabazuar.

6. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi ka argumentuar se në rastin e kërkesës për ekstradim drejt Republikës së Polonisë mungojnë garancitë që duhet të lëshohen nga autoriteti qendror, pra nga ministri i Drejtësisë së Republikës së Polonisë se ai nuk do të ndiqet për vepra të tjera penale, përveç atyre për të cila akuzohet dhe se nuk do të ekstradohet më tej në Republikën e Koresë së Jugut. Sipas kërkuesit, termi “dhe të tjerë” i përdorur në kërkesën e ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Polonisë është identik me atë të përdorur nga ai i Republikës së Koresë së Jugut, që do të thotë se në rastin e tij shteti polak nuk ka ofruar garancitë e kërkuara. Po kështu, sipas tij, autoritetet polake pranojnë hapur në *difuzionin* e datës 05.01.2024 se kërkuesi po ndiqet penalisht edhe për vepra penale të kryera në vende të tjera, pa specifikuar se cilat janë këto vende dhe nëse përfshihet edhe Republika e Koresë së Jugut. Kjo deklaratë, sipas kërkuesit, shkel hapur *parimin e specialitetit* dhe vendimin e datës 25.07.2024 të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se *procedura e ekstradimit është e paligjshme*, në kushtet kur ai ka kërkuar azil në Republikën e Shqipërisë ndaj Republikës së Polonisë dhe në kushtet kur kërkesa për azil është ende në proces shqyrtimi, lejimi i ekstradimit do të përbente shkelje flagrante të legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar, si Konventa për Refugjatët, dispozitat e Komisionit të Lartë të OKB-së për Refugjatët dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

7. Shumica i ka vlerësuar pretendimet e kërkuesit si haptazi të pabazuara. Kështu, ajo (shumica), pasi ka analizuar vendimin e Gjykatës së Lartë në të cilin gjendet e cituar literalisht kërkesa e ministrit të Drejtësisë së Republikës së Polonisë, ka vlerësuar se nuk konstatohet ndonjë arsye serioze për të vënë në dyshim interpretimin e ligjit që ajo gjykatë u ka bërë fakteve të çështjes së kërkuesit. Për më tepër, sipas shumicës, nga autoritetet gjyqësore shqiptare tashmë ka një

vendim gjyqësor përfundimtar që nuk e lejon ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Po kështu, sipas shumicës, kërkuesit i janë dhënë mjaftueshëm arsye edhe se përse rasti konkret, ai i shqyrtimit të kërkesës për ekstradimin drejt Republikës së Polonisë, nuk gjendej në të njëjta kushte me atë të shqyrtimit të kërkesës për ekstradimin drejt Republikës së Koresë së Jugut. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka analizuar në mënyrë të arsyeshme përdorimin e termit “*dhe të tjerë*” në kërkesën e ministrit të Drejtësisë të Republikës së Polonisë, ndaj përfundimi i arritur nga ajo gjykatë nuk rezulton i paarsyeshëm, pasi nuk përmban as të meta serioze që të vërë në dyshim standardet kushtetuese (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Ndërsa për sa i takon kërkesës për azil ndaj Republikës së Polonisë, shumica ka çmuar se shtesa e kërkesës për azil, e paraqitur pasi procedura gjyqësore për lejimin e ekstradimit në Republikën e Polonisë u bë përfundimtare, nuk përbën rrethanë që të vendosë në dyshim vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme për lejimin e ekstradimit (*shih paragrafin 45 të vendimit*).

8. Ne gjyqtarët në pakicë jemi kundër këtyre qëndrimeve, pasi vlerësojmë se përdorimi i termit “*dhe të tjerë*” në shkresën e ministrit të Drejtësisë së Republikës së Polonisë, ku citohen veprat penale për të cilat kërkuesi akuzohet në atë shtet, përmban paqartësi, e cila passjell pasiguri për individin – kërkuesin. Kjo pasiguri vjen jo vetëm për shkak të mospërcaktimit të qartë të veprave penale për të cilat kërkuesi do të ndiqet në shtetin polak, por edhe sepse në të mungon i shprehur konfirmimi - garancia se kërkuesi nuk do të ekstradohet në vende të treta përfshirë edhe Republikën e Koresë së Jugut. Në këtë pikë vëmë në dukje se pikërisht për shkak të së njëjtës pasiguri, Gjykata e Lartë nuk lejoi ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut, pasi sipas saj në atë rast u konstatuan shkelje të garancive dhe mospërbushje të parimit të specialitetit. Lidhur me këtë të fundit, vëmë në dukje se mospranimi i kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit në atë shtet (Republika e Koresë së Jugut) qëndronte pikërisht për faktin se kërkesa nuk përmbushte kushtin e garancisë dhe shkelte parimin e specialitetit për shkak të përmbajtjes së termit “*etj.*”, i cili sipas Gjykatës së Lartë linte të hapur mundësinë që pas ekstradimit kërkuesi të akuzohej edhe për vepra të tjera penale. Ndërsa në rastin në shqyrtim kërkesa për ekstradim, e cila substancialisht përbën një akt të njëanshëm të ministrit të Drejtësisë dhe formalisht është paraqitur po njësoj, plotëson kushtet e garancisë dhe përmbush kriteret e parimit të specialitetit. Thënë kjo, gjykatat e zakonshme, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, por edhe shumicën që ka vlerësuar arsyetimin e asaj gjykate si pa të meta, nuk kanë arritur të qartësojnë se ku qëndron ndryshimi dhe përse kërkesa e autoriteteve të drejtësisë polake për ekstradimin e kërkuesit përmbush garancitë e kërkuara në ndryshim nga kërkesa për ekstradimin e tij nga

autoritetet koreane jugore, për sa kohë evidentohet e njëjta situatë *ambiguous* lidhur me përdorimin e të njëjtit term “dhe të tjerë”/“etj.” në aktet e tyre.

9. Për sa më lart, në kushtet kur nga autoritetet e drejtësisë polake nuk janë dhënë në mënyrë të shprehur garancitë se kërkuesi nuk do të ndiqet për vepra të tjera penale përveç atyre të cituara dhe se ai nuk do të ekstradohet më tej nga Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut, çmujmë se ka vend për një vlerësim më të thelluar të procedurës. Për këtë shkak, por edhe për faktin se vetë Gjykata e Lartë vendosi në datën 25.07.2024 moslejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Koresë së Jugut, ekziston mundësia që ky vendim i kësaj gjykate të jetë nul dhe i pavlerë.

10. Nga ana tjetër, në gjyqtarët në pakicë e vlerësojmë të pabazuar edhe qëndrimin e shumicës për sa i përket mosmarrjes në konsideratë të rrethanës që lidhej me faktin se kërkuesi ka paraqitur një kërkesë për azil, gjë e cila kufizon procedurat e ekstradimit deri në dhënien e një vendimin përfundimtar nga autoritetet kompetente. Konkretisht, sikurse ka rezultuar nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, kërkuesi, bazuar në ligjin për azilin në Republikën e Shqipërisë, ka paraqitur kërkesë për azil (mbrojtje ndërkombëtare) në shtetin shqiptar ndaj shtetit polak.

11. Në analizë të kësaj rrethane evidentojmë se parashikimet e legjislacionit shqiptar garantojnë të drejtën e shtetasve të huaj për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo do të thotë se në rastet kur një kërkues ka paraqitur kërkesë për azil në Republikën e Shqipërisë, përgjegjësia kryesore për t’i ofruar mbrojtje atij i takon shtetit shqiptar (*shih vendimin nr. 2, datë 29.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga ana tjetër, garancitë për mbrojtjen ndërkombëtare të ofruara nga autoritetet kompetente shqiptare në rastin e kërkesave për azil përforcohen edhe nga normat dhe standardet ndërkombëtare të pranuar nga Republika e Shqipërisë. Referuar konventës për refugjatët të vitit 1951 (Konventa e Gjenevës) dhe udhëzuesve të UNHCR-së, në raport me rrethanat e rastit në fjalë, vihet në dukje se vendimet për kërkesën për azil dhe për kërkesën për ekstradim, përkatësisht, duhet të merren në procedura të veçanta dhe shteti i kërkuar është i detyruar, sipas akteve ndërkombëtar të refugjatëve dhe të drejtave të njeriut, të sigurojë respektimin e plotë të parimit të moskthimit.¹

¹ Shih *UNHCR Comments to the Council of Europe’s Committee of Experts on the Operation of European Conventions on Co-operation in Criminal Matters (PC-OC) On the Replies to the Questionnaire on the relationship between asylum procedures and extradition procedures – Prill 2009* - <https://rm.coe.int/168058f749>

13. Në analizë të sa më sipër, përkundër vlerësimit të shumicës, ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se në rastin konkret dhënia e një vendimi përfundimtar nga autoritetet kompetente për pranimin ose mospranimin e kërkesës për azil përbën një situatë që duhet të merret në konsideratë. Kjo, pasi në kuadër të së drejtës ndërkombëtare dhe në respektim të detyrimeve konventore një kërkesë për ekstradim nuk duhet të përjashtojë një azilkërkues nga aksesimi në procedurat e azilit ose nga mundësia që kërkesa e tij për azil të shqyrtohet në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Konventën e Gjenezës dhe aktet shoqëruese të saj. Thënë kjo, lejimi i ekstradimit të kërkuarit përpara shqyrtimit të kërkesës së tij për azil në Republikën e Shqipërisë, e shndërron të drejtën për të kërkuar azil në një të drejtë iluzore.

14. Nën këtë optikë, çmojmë se Gjykata kishte detyrimin t'i shqyrtonte në seancë plenare pretendimet e kërkuarit në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, duke konsideruar edhe faktin e ri që lidhej me kërkesën e tij për azil në Republikën e Shqipërisë. Kjo rrethanë e analizuar bashkërisht me mungesën e garancive se kërkuari nuk do të ndiqej për vepra të tjera penale përveç atyre të cituara në shkresën e ministrit të Drejtësisë dhe se nuk do të ekstradohej më tej nga Republika e Polonisë në Republikën e Koresë së Jugut, përbënin mjaftueshëm arsye që Mbledhja e Gjyqtarëve të vendoste kalimin për shqyrtim në seancë plenare të ankimit kushtetues individual të kërkuarit.

15. Nën dritën e sa më sipër, duke qenë se pretendimet e kërkuarit nuk duken të jenë haptazi të pabazuara, lindte nevoja për vlerësimin në themel të tyre nga Gjykata në seancë plenare.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahim